



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Gusht 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Drejtoria komunale e Arsimit, gjatë muajit gusht të vitit 2016, ka realizuar të gjitha punët dhe detyrat e planifikuara sipas dinamikës së paraparë për këtë periudhë kohore dhe, njëkohësisht punë dhe detyrat të tjera të paraqitura.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Vizita informuese në gjitha institucionet edukativo-arsimore;
- Trajnime permanent për zhvillimin profesional të personelit edukativ-arsimor, në bashkëpunim me (MASHT-in, OJQ-të);
- Analiza e nevojave për stafin menaxhues dhe hartimi i plan të trajnimit;

- Organizimi i trajnimeve për stafin menaxhues, në përputhje me nevoja dhe planet e trajnimeve;
- Zbatimi i stimulimit për sukses në menaxhimin e institucionet edukativo-arsimore;
- Kontrollim dhe monitorim i rregullt i institucioneve parashkollore sipas dinamikës së planifikimit;
- Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme qeveritare (MASHT);
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimit joformal në tri nivelet e arsimit parauniversitar (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisit Profesional);
- Themelimi i institucioneve parashkollore me komunitetin në bazë;
- Përgatitja dhe trajnimi i mësimdhënësve për implementimin e kurrikulit të ri (në bashkëpunim me MASHT, IPK);
- Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme: FE, drejtoritë komunale, bibliotekat, muzeun, klubet sportive, etj;
- Punësimi i personelit të ri, në përputhje me nevojat;
- Themelimi i paraleleve të reja parashkollore në kuadër të shkollave fillore (bashkëpunim me MASHT);
- Pajisja e bibliotekave shkollore me literaturë profesionale, tekste mësimore dhe libra (bashkëpunim me bibliotekat në nivel komune dhe vendi, me komunitetin);
- Organizimi dhe zhvillimi i Testit shtetëror të maturës, afati i gushtit 2016;
- Procesimi i të dhënave në sistemin SMIA për të gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit parauniversitar;
- Nënshkrimi i kontratës “Furnizimi me dru për institucionet arsimore” dhe fillimi i furnizimit me dru;
- Vlerësimi i tenderit “Furnizimi me pelet për institucionet arsimore”;
- Përfundimi i dezinfektimit të institucioneve edukativo-arsimore;
- Fillimi i realizimit të kontratës “Furnizimi me inventar për institucionet arsimore”;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me libra shkollorë;
- Sigurimi i të dhënave për planifikimin e buxhetit;
- Përgatitja e tenderëve për mallra dhe shërbime;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përgatitja dhe kompletimi i lëndëve për Petty-Cash;
- Përcjella dhe realizimi i projekteve nga banka;
- Kërkesat për transportin e nxënësve, arsimtareve dhe fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;

- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Aprovimi i pagesave;
- Barazimi i pagesave me freebalance;
- Përgatitja e raportit tremujor;
- Furnizimi i institucioneve shkollore me material didaktik, material higjienik;
- Implementimi i Protokollit për parandalimin dhe referimin e akteve të dhunës në arsimin parauniversitar;
- Përmirësimi i infrastrukturës për rastet emergjente;
- Shfrytëzimi i sigurt i internetit në shkolla;

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë, gjatë muajit gusht, kanë realizuar **vizita** speciale dhe kontrolluese në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar;
- Gjatë muajit gusht, Drejtoria e Arsimit ka organizuar takim me drejtuesit e institucioneve të nivelit të arsimit parauniversitar, takimi i cili kishte karakter informues dhe bashkëpunues rreth përgatitjeve të vitit të ri shkollor;
- Drejtoria e Arsimit, për plotësimin e vendeve të lira, në të gjitha institucionet e nivelet të arsimit parauniversitar, më 25 korrik 2016, ka hapur konkurs për 96 pozita për mësimdhënës të niveleve të ndryshme, dhe gjatë muajit gusht ka realizuar të gjitha intervistat për këto pozita. Kështu që, mësimdhënësit e përzgjedhur sipas kualifikimeve dhe performancës së treguar gjatë intervistimit kanë lidhur kontratë pune;
- Po ashtu, gjatë muajit gusht është formuar komisioni për përzgjedhjen e stafit drejtues në institucioneve edukativo-arsimore, për 18 pozita të shpallura. Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacioneve të konkurrenteve, ka vendosur që tetë pozitat e shpallura për drejtues të institucioneve parashkollore, konkursi të anulohet, ndërsa në dhjetë (10) pozita për drejtues në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, intervistat janë realizuar;

- Realizimin e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme të larta në afatin e gushtit;
- Zyrtarët e lartë të arsimit, gjatë muajit gusht kanë realizuar vizitë speciale në shkollën fillore “Andon Z. Çajupi” dhe shkollën fillore “Xhemail Mustafa” për t’i shqyrtuar ankesat e drejtuar në DKA;
- Janë realizuar të gjitha përgatitjet e domosdoshme në shkolla, që do të zhvillohet mësimin me qëndrim tërëditor nga vitit shkollor 2016/17, e këto janë: SHFMU "Emin Duraku", SHFMU "Pjetër Bogdani", dhe SHFMU "Ganimete Tërbeshi";
- Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar vizitat informuese në institucionet arsimore, për t’u informuar lidhur me përgatitjet e nevojshme për fillim vitin shkollor 2016/17;
- Drejtorja e Arsimit, për t’i plotësuar nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore, këtë vit ka hapur edhe tri paralele të reja: në Shkollën e Gjelbër, në shkollën “Ganimete Tërbeshi” dhe në shkollën fillore “Nëna Terezë”-Vranidoll;
- Trajnimi permanent për zhvillimin profesional të personelit edukativ-arsimor, në bashkëpunim (MASHT, OJQ-të);
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Vizita në shkolla, sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit gusht;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Më 27 gusht dhe 3 shtator 2016, në autoritetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe drejtorive komunale të arsimit, u organizua “Testi shtetëror i maturës” në nivel vendi, me nxënësit e klasave të dymbëdhjeta (XII). Këtij testit në komunën e Prishtinës iu nënshtruan 1356 nxënës, të cilët nuk arritën të shënojnë rezultate në afatin e qershorit. Drejtorja e Arsimit në kohë optimale, i ka bërë të gjitha përgatitjet e domosdoshme për një proces të drejtë, duke organizuar testin në nëntë **(9) qendra** dhe katërbëdhjetë **(14) nënqendra**, me qëllim të krijimit të kushteve dhe standardeve më të mira për punë, gjë që ka reflektuar pozitivisht në mbarëvajtjen e testit. Për këtë proces Drejtorja e Arsimit ka angazhuar **86** monitorues dhe administruues, të cilët kanë qenë të ngarkuar për mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së punës gjatë mbajtjes së “Testit shtetëror të maturës” në komunat tjera të Republikës së Kosovës. Drejtorja e Arsimit ka

organizuar dhe siguruar transportimin e tyre, në kohën e duhur, dhe janë shpërndarë në qendrat e caktuara;

- Janë përpunuar dhe futur të dhënave në sistemin SMIA, nga të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar;
- Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në kohën e planifikuar ka realizuar shpërndarjen e teksteve shkollore për të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, ku zhvillohet mësimi i obliguar, për vitin shkollor 2016/17;
- Grumbullimi dhe përfundimi i raportit për braktisjen e nxënësve në gjitha nivelet e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2015/16;
- Drejtoria e Arsimit, në kohë të planifikuar ka realizuar dezinfektimi i institucioneve edukativo-arsimore;
- Në kohë të planifikuar janë regjistruar të gjitha lëndët financiare në databazë;
- Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë furnizuar 5 salla të edukatës fizike me komplet rekuizitat sportive;
- Kanë filluar procedurat për tenderin "Furnizimi me dru për institucionet arsimore";
- Kanë filluar procedurat për tenderin "Furnizimi me pelet për institucionet arsimore";
- Kanë përfunduar procedurat për tenderin "Furnizimi i shkollave me pajisje kabinetike";
- Janë nënlokuar pagat për 64 institucione shkollore;
- Janë nënlokuar mjetet për mallra dhe shërbime për programe dhe nënprograme;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Janë zotuar 89 lëndë për mallra dhe shërbime si shërbime komunale;
- Janë shpenzuar dhe certifikuar 60 lëndë;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga dy përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Aprovimi i kërkesave të institucioneve shkollore lidhur me shpenzime nën 100 Euro;
- Mbajtja e evidencës e lëndëve të zotuar me modul blerjes si dhe dorëzimi në prokurim;
- Është përfunduar vlerësimi i ofertave për projektin "Ndërtimi i Aneksit në shkollën "Faik Konica"", është bërë nënshkrimi i kontratës, pritet fillimi i punimeve;
- "Rikonstruktimi dhe gëlqerosja e shkollave, është përfunduar vlerësimi;

- Instalimet e reja të ngrohjes qendrore në shkolla të fshatrave (është duke u bërë vlerësimi);
- Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive (është duke u bërë vlerësimi);

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Përgatitja e raportit për suksesin dhe zhvillimet në arsim gjatë vitit shkollor 2015/16;
- Raportimi në SMIA nga institucionet edukativo-arsimore të nivelit parauniversitar;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me inventar;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me dru;
- Ka përfunduar vlerësimi për tenderin “Furnizimi me pelet për institucionet arsimore”;
- Është duke u realizuar furnizuar institucionet arsimore me inventar;
- Është në realizim e sipër projekti për furnizimin e bibliotekave shkollore me libra etj.;
- Përcjellja e shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Transporti për nxënës dhe arsimtarë;
- Menaxhimin e kontratave për mallra dhe shërbime;
- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet shkollore;
- Në implementim e sipër është realizimi i kontratës, si: “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU “7 Marsi”, “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në Hajvali”, “Rregullimi i oborrit të shkollës “Ismail Qemali”, “Ndërtimi i çerdhes në IP Kodra e Trimave”, “Rikonstruimi i nyjeve sanitare në disa shkolla të Prishtinës”, dhe rikonstruimi dhe mirëmbajtja e kulmeve në institucionet edukativo-arsimore, Gëlqerosja e shkollave “Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore “Faik Konica”, rikonstruimi i çerdhes në Sofali “Fillimi i punimeve në objektin e shkollës në lagjen Arbëri, se shpejti;

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me

palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtorja juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës

5.1.1. Buxhetin e planifikuar dhe të shpenzuar për periudhën raportuese, gusht 2016.

Kategoria ekonomike	Vlera e alokimit	Shpenzimi për muajin korrik	Zotimet dhe obligimet	Mbetja ne FB
Pagat	1.459.440,48	1.459.440,48		0
10-Mallra dhe shërbime	58.858,85	24.314,72		34.544,13
21-Mallra dhe shërbime	223.648,78	105.001,61		118.647,17
Komunali	155.142,22	24.549,81		130.592,41
Subvencionet	125.224,00	54.025,00		71.199,00
Donacionet	4.004,50	2.000,00		2.004,50
Kapitalet	2.504.395,79	601.306,07		1.903.089,72

5.1.2. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit gusht ka realizuar mbi 120 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara çdo ditë.

5.1.3. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit gusht të vitit 2016, janë realizuar:

- Takime me zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Takim me përfaqësuesit e OSBE;
- Takimet e rregullta me Ministrinë e Financave;
- Takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore;
- Takim me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës;
- Takim me përfaqësuesit e KUR "Prishtina";
- Takim me përfaqësuesit e NPL "Termokos";
- Takimet me përfaqësuesit e KEDS;

5.1.4. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare;

- Gjatë muajit gusht nuk ka pasur kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

5.1.6. Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit korrik janë pranuar gjithsej 80 lëndë, prej tyre të miratuara janë 10 lëndë, të pezulluara 25, në proces janë 45 lëndë.

5.1.7. Takime të tjera

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Dislokimi i Drejtorisë së Arsimit në objektin e ri të Komunës dhe kushte jo optimale të punës, do reflekton drejtpërsdrejti në cilësinë dhe realizimit të punëve dhe detyrave;
- Implementimi i Kurrikulit të ri;
- Ndërtimi i objekteve shkollore në disa lagje të qytetit;
- Sistemimi i mësimdhënësve të cilët janë rrezikuar si pasojë e ndryshimeve të planit mësimor (fondin e orëve), në shkollat ku është duke u implementuar KKK;
- Plotësimi i vendeve të lira me staf arsimor në institucionet e nivelet të arsimit parauniversitar;

7. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë komunale të Arsimit, në bazë të përgjegjësiave, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës;
- Përmirësimi i pozitës materiale të stafit profesional të Drejtorisë së Arsimit.

8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

Shpallja e tenderëve të planifikuar:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita informuese në gjitha institucionet edukativo-arsimore;
- Kontrollim dhe monitorim i rregullt institucioneve parashkollore sipas dinamikës së planifikimit;
- Analiza e nevojave për stafin menaxhues dhe hartimi i plan të trajnimit;
- Organizimi i trajnimeve për stafin menaxhues, në përputhje me nevoja dhe planet e trajnimeve;
- Implementimi i Protokollit për parandalimin dhe referimin e akteve të dhunës në arsimin parauniversitar;
- Implementimi i mekanizmave të krijuara dhe formularëve standard për përzgjedhjen e kuadrit udhëheqës-menaxhues dhe profesional nëpër shkolla;
- Fuqizimi i Këshillit drejtues të shkollës;
- Themelimi i institucioneve parashkollore me komunitetin në bazë;
- Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme qeveritare (MASHT);
- Organizimi i trajnimeve permanente për zhvillim profesional të personelit edukativ (MASHT, OJQ-të);
- Pajisja e bibliotekave shkollore me literaturë profesionale, tekste mësimore dhe libra (bashkëpunim me bibliotekat në nivel komune dhe vendi, me komunitetin);
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Përgatitja dhe trajnimi i mësimeve për implementimin e Kurrikulit të ri (në bashkëpunim me MASHT, IPK);
- Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme: FE, drejtoritë komunale, bibliotekat, muzeun, klubet sportive etj.;
- Përgatitja e konkursit për mësim joformal në institucionet e arsimit të mesëm të lartë;

- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2016/17;
- Zotimi i lëndëve me modul blerje;
- Shpenzimi dhe certifikim i lëndëve mallra dhe shërbime;
- Zotimi i lëndëve kapitale;
- Barazimi me Bankën Botërore me të dhënat e buxhetit;
- Përmirësimi i infrastrukturës për rastet emergjente;
- Përfundimi i kontratës për furnizimin e institucioneve arsimore me inventar;
- Realizimi i kontratës për furnizimin e bibliotekave shkollore me libra;
- Furnizimi në mënyre sistematike i nxënësve me kiflet;
- Furnizimi në mënyre sistematike me qumësht;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Janë duke u përgatit kontratat si “Mirëmbajtja e elektrikes”, “Rikonstruktimi i kuzhinës qendrore të IP në lagjen “Ulpiana””, “Instalimet e reja të ngrohjes qendrore në shkollat të fshatrave”.

9. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme